# DËSHMI ARKIVI

**A-461205**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | KPP rrëzon ankesën për stacionin hekurudhor të Rinasit, hapet rruga për vijimin e projektit |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/kpp-rrezon-ankesen-per-stacionin-hekurudhor-te-rinasit-hapet-rruga-pe-i105157` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 21 shtator 2026, 05:42:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 21 shtator 2026, 05:28:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b2a7274c2116c7e7e87dca869714230d18efb15f54f8797238783b150d74150` |
| TEKSTI | `a0741c380ebf954a10631f316b1ed4020f0587c5f5a220238e33e42fa4d887c5` |
| PAMJA | `061cc09c9389f83c47e18359f1ff8bdee78c338b300584259a58103b93993057` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `90cfcd0177e64b721dbf42e5a839b369830b0dbd2865e9305775651b58be2e67` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d754d95d3fb9effc97224ab6ddd249dd26dc09b477f9e15caf646cb8e3153b6a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/90cfcd0177e64b721dbf42e5a839b369830b0dbd2865e9305775651b58be2e67`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# KPP rrëzon ankesën për stacionin hekurudhor të Rinasit, hapet rruga për vijimin e projektit

Piranjat Përditësimi i fundit 21 Shtator 2026, 07:28



Komisioni i Prokurimit Publik rrëzoi ankesën për tenderin e stacionit hekurudhor të Aeroportit të Rinasit, duke i lejuar Hekurudhës Shqiptare të vijojë procedurën për kontratën fond limit 91.7 milionë lekë pa TVSH apo rreth 960 mijë euro.

Objekti i kontratës përfshin si hartimin e projektit të detajuar inxhinierik dhe arkitektonik, ashtu edhe ndërtimin e godinës së stacionit, pra një kontratë projektim-ndërtim me formulën "çelësa në dorë".

Në vendimin e 16 shtatorit, KPP përcaktoi "të mos pranojë ankesën" e operatorit ekonomik dhe se "autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit".

Operatori ankimues kishte paraqitur ofertë prej 76.6 milionë lekësh, por ishte skualifikuar. Operatori i shpallur fitues paraprak kishte ofruar 81.1 milionë lekë, ndërsa një tjetër ofertues i kualifikuar kishte paraqitur ofertë rreth 87 milionë lekë.

Mosmarrëveshja lidhej me mënyrën se si operatori ankimues kishte deklaruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për plotësimin e kërkesave për licencat profesionale dhe stafin teknik.

KPP vlerësoi se dokumentacioni "nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm", duke arritur në përfundimin se pretendimi i operatorit "nuk qëndron".

Stacioni do të zhvillohet në një sipërfaqe prej rreth 6,287 metrash katrorë, ndërsa godina do të ketë rreth 260 metra katrorë. Projekti parashikon salla pritjeje, sportele dhe makina automatike për bileta, ambiente shërbimi, sisteme sigurie dhe hapësira parkimi.

Dokumentacioni kërkon gjithashtu që objekti të projektohet si një "stacion i gjelbër", me eficiencë energjetike, ndriçim natyral, panele fotovoltaike dhe sisteme për mbledhjen e ujërave të shiut. Stacioni është pjesë e projektit më të gjerë për rehabilitimin e linjës Tiranë-Durrës dhe ndërtimin e degëzimit drejt Aeroportit "Nënë Tereza". Projekti përfshin rreth 40 kilometra linjë dhe synon një kohë udhëtimi prej rreth 12 minutash mes Tiranës dhe aeroportit dhe rreth 22 minutash mes Tiranës dhe Durrësit.

Sipas dokumenteve zyrtare, shërbimi për pasagjerët parashikohet të nisë në fund të vitit 2027 edhe pse me ecurinë e deritanishme mbetet për tu parë nëse kjo do të finalizohet./ Monitor

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 21 Shtator07:24

### Mot i paqëndrueshëm, mesdita sjell reshje shiu në pjesën më të madhe të territorit

Moti parashikohet me kthjellime e gradualisht shtim vranësirash mesatare deri të dendura në të gjithë territorin. Reshje shiu me int...

AKTUALITET 21 Shtator07:03

### Si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE-së me çmimet e ushqimeve?

Prej më shumë se tri dekadash, prioriteti i qeverive shqiptare ka qenë integrimi i vendit në Bashkimin Europian. Madje qeveria aktuale e k...

AKTUALITET 20 Shtator21:09

### Trafik i rënduar në aksin Lezhë-Milot, qytetarët prej disa orësh të 'bllokuar'

Mbrëmja e kësaj të diele është shoqëruar me trafik të rënduar në aksin rrugor Lezhë-Milot. Moti i mirë d...

AKTUALITET 20 Shtator20:12

### Banda e "udhëtarëve" i shkoi në shtëpi në mes të natës, zbardhet dëshmia e autorit të vrasjes së 36-vjeçarit shqiptar

'Jam i dëshpëruar.' Kjo është deklarata e Roberto Mollo, 35-vjeçarit italian që gjatë natës qëlloi me...

AKTUALITET 20 Shtator19:42

### Qeveria u kërkoi fitimin e fshehur/ Pse e refuzuan Ramën tregtarët e ushqimeve

Të premten në mesditë, në një nga sallat e kryeministrisë ishin ftuar pronarët e supermarketeve, që prej dy javësh ...

AKTUALITET 20 Shtator19:12

### EMRI/ U vra nga pronari italian i banesës, kush është 36-vjeçari shqiptar, babai i një fëmije

Burri që u vra mbrëmë në Baldissero d'Alba quhej Gjovalin Lazri. Dyshohet se ai hyri në oborrin e shtëpisë në ferm...

AKTUALITET 20 Shtator18:05

### Vrasja e Artan Myrtajt në Sarandë/ Hita mbledh drejtuesit e Policisë

Pas vrasjes së 44-vjeçarit me armë zjarri dhe plagosjes së një 73-vjeçari, i cili mbeti i lënduar rastësisht, Drejto...

AKTUALITET 20 Shtator17:44

### Sherr për motive sentimentale/ Nën hetim 5 shqiptarë dhe shoku i tyre

Një konflikt për motive sentimentale ka përfshirë gjashtë persona të shtunën në mbrëmje pranë një lokali ...

AKTUALITET 20 Shtator17:20

### EMRAT/ Zhduken 4 të rinj shqiptarë në Britani

Shërbimet sociale në Angli i kanë kërkuar ndihmë publikut për lokalizimin e katër të rinjve shqiptarë të kateg...

AKTUALITET 20 Shtator17:09

### Aksident rrugor në aksin nacional Maqellarë–Peshkopi, plagosen nënë e bir

Një aksident rrugor ka ndodhur pak minuta më parë në aksin nacional Maqellarë–Peshkopi. Si pasojë e kësaj janë...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 20 Shtator

### [Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e ...]

Artan Myrtaj është 44-vjeçari që u ekzekutua ditën e sotme me armë zjarri në qendër të Sarandës. Ai njihej...

AKTUALITET 20 Shtator

### [EMRI/ U vra nga pronari italian i banesës, kush...]

Burri që u vra mbrëmë në Baldissero d'Alba quhej Gjovalin Lazri. Dyshohet se ai hyri në oborrin e shtëpisë në ferm...

LIFESTYLE 20 Shtator

### [FOTO/ Brenda botës së eskortave meshkuj me "kat...]

Paratë mund të blejnë shumë gjëra, por dashurinë nuk e kanë blerë kurrë, dhe një llogari bankare e mbushur n...

INVESTIGIME 19 Shtator14:14

### [Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës]

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**




**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.